

# Treguesit demografikë

## Tremujori IV – 2022


**Tiranë, më 10 shkurt 2023:** Shënim: Në kuadër të përafrimit të metodologjisë me Eurostat, si dhe përmirësimit cilësor të statistikave vitale, të dhënat e tremujorit të katërt 2022 janë paraprake. Të dhënat vitale finale për vitin 2022 do të publikohen me “Popullsinë e Shqipërisë, 1 Janar 2023”.

Numri i lindjeve për tremujorin e katërt 2022 është 5.963, duke shënuar një rënie me 13,7 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2021.

Numri i vdekjeve për tremujorin e katërt 2022 është 4.916, duke shënuar një rënie prej 37,0 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2021.

Shtesa natyrore e popullsisë në tremujorin e katërt 2022 tregon se janë 1.047 lindje më shumë se sa vdekje.

Fig. 1 Shtesa natyrore e popullsisë




\*\* Të dhëna janë paraprake

Për publikim: më 10 shkurt 2023

Në tremujorin e katërt 2022, shtatë qarqe të vendit kanë shënuar shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në pesë qarqet e tjera, shtesa natyrore e popullsisë ishte negative.

Në tremujorin e katërt 2022, qarku me shtesën natyrore më të lartë është Tirana, me 863 lindje më shumë sesa vdekje, ndërsa qarku me shtesën natyrore më të ulët është Korça, me 187 vdekje më shumë se sa lindje.

Fig. 2 Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T4– 2022\*\*



\*\* Të dhëna janë paraprake

### Lindjet

Në tremujorin e katërt 2022, të gjitha qarqet e vendit shënuan ulje të numrit të lindjeve, në krahasim me tremujorin e katërt 2021.

Në tremujorin e katërt 2022, qarku me numrin më të lartë të lindjeve është Tirana me 2.121 lindje, ndërsa qarku me numrin më të ulët është Gjirokastra me 93 lindje.

Rënien më të vogël në përqindje të lindjeve, gjatë tremujorit të katërt 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 e zë qarku i Shkodrës me 8,0 %, ndërsa rënien më të madhe e ka qarku i Korçës me 28,2 %.

**Tab. 1 Lindjet sipas qarqeve**

Nr.	Qarku	IV - 21	I - 22**	II - 22**	III - 22**	IV - 22**
	<b>Shqipëria</b>	<b>6.911</b>	<b>6.056</b>	<b>5.384</b>	<b>6.172</b>	<b>5.963</b>
1	Berat	283	223	201	252	208
2	Dibër	328	280	292	301	292
3	Durrës	747	666	589	680	682
4	Elbasan	619	514	473	592	544
5	Fier	584	532	431	520	513
6	Gjirokastër	113	106	85	90	93
7	Korçë	411	301	300	331	295
8	Kukës	225	187	190	209	201
9	Lezhë	328	309	255	286	278
10	Shkodër	462	403	369	428	425
11	Tiranë	2.499	2.194	1.940	2.172	2.121
12	Vlorë	285	314	229	270	253
	*Të panjohur	27	27	30	41	58

\*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar lindja mungon<sup>1</sup>

\*\* Të dhëna janë paraprake

## Vdekjet

Në tremujorin e katërt 2022, të gjitha qarqet e vendit shënuan ulje të numrit të vdekjeve, në krahasim me tremujorin e katërt 2021.

Në tremujorin e katërt 2022, qarku me numrin më të ulët të vdekjeve është Kukësi me 119 vdekje, ndërsa qarku me numrin më të lartë është Tirana me 1.258 vdekje.

Uljen më të madhe në përqindje të vdekjeve, gjatë tremujorit të katërt 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 e zë qarku i Beratit me rënie prej 46,6 %.

<sup>1</sup> Shiko metodologjinë në linkun në vijim: <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/#tab4>

**Tab. 2 Vdekjet sipas qarqeve**

Nr.	Qarku	IV - 21	I - 22**	II - 22**	III - 22**	IV - 22**
	<b>Shqipëria</b>	<b>7.809</b>	<b>7.938</b>	<b>4.916</b>	<b>5.130</b>	<b>4.916</b>
1	Berat	453	418	279	261	242
2	Dibër	263	292	217	204	181
3	Durrës	696	762	467	484	456
4	Elbasan	743	806	506	499	485
5	Fier	902	909	583	545	561
6	Gjirokastër	279	267	169	177	163
7	Korçë	760	680	493	470	482
8	Kukës	165	146	97	126	119
9	Lezhë	319	388	219	237	231
10	Shkodër	608	660	412	464	361
11	Tiranë	2.039	1.991	1.119	1.244	1.258
12	Vlorë	573	614	344	398	370
	<i>*Të panjohur</i>	9	5	11	21	7

\* Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja mungon.

\*\* Të dhëna janë paraprake

# Metodologjia

Të dhënat tremujore për lindjet dhe vdekjet, në nivel kombëtar dhe qarku përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Këto të dhëna publikohen mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026.

## Lindjet

### *Të dhënat e lindjeve:*

Të dhënat e lindjeve sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

### *Regjistrimet e vona të lindjeve*

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i lindjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

## Vdekjet

### *Të dhënat e vdekjeve*

Të dhënat e vdekjeve, sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e vdekjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

### *Regjistrimet e vona të vdekjeve*

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i vdekjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

**Përkufizime:**

*Shtesa natyrore e popullsisë:* Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

*Lindje e gjallë:* Lindja e fëmijëve që shfaqin ndonjë shenjë jete.

*Vdekje:* Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).